




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK
 Nr. Prot. 01-198/2013
 Br. Prot. 01-198/2013
 Prot. No. 01-198/2013
 Data 30-01-2013
 Datum 30-01-2013

Nr. i faq. 02
 Broj stranica 02
 Nr. pages 02

PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	22.01.2013
REFERENC-Ë:	AKK-DPK- 4418/12
PËR/ZA/TO:	z. Isa Lahi, Auditor i Brendshëm në Komunën e Prishtinës
CC:	
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion



I nderuari z. Lahi,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 5 dhe 1. 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë :

OPINION

Bazuar në kërkesën tuaj drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit të datës 11.12.2012, për t'ju këshilluar lidhur me aplikimin tuaj për pozitën e anëtarit të bordit të drejtorëve në ndërmarrjen publike komunale “Stacioni i Autobusëve” sh.a. Prishtinë, se a mund të ketë konflikt të interesit nëse zgjidheni, me ushtrimin e funksionit tuaj aktualë si auditor i brendshëm i komunës së Prishtinës, ju njoftojmë se :

Funksioni i juaj si auditor i brendshëm i Komunës së Prishtinës hyn në listën e zyrtarëve të lartë publike të paraparë sipas ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, po ashtu edhe pozita të cilën ju keni aplikuar për tu zgjedhur si anëtar i bordit të drejtorëve në ndërmarrjen publike komunale “Stacioni i Autobusëve” sh.a. Prishtinë, konsiderohet si funksion i lartë publik i paraparë po sipas këtij ligji, andaj ju njoftojmë se: ushtrimi i këtyre dy funksioneve publike në të njëjtën kohë paraqet mos pajtueshmëri dhe

kufizim në ushtrim të funksionit publik të paraparë sipas nenit 16.1 të ligjit Nr.04/L-051, po ashtu duhet pasur parasysh se Institucioni i Komunës së Prishtinës ku ju ushtroni pozitën e auditorit të brendshëm, është aksionari kryesor në këtë kompani publike andaj angazhimi i juaj në këtë pozitë do të ishte shkelje e parimeve të zyrtarit të lartë të paraparë sipas nenit 7 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Me respekt!

